



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE

Nr. 8801 Prot., datë 10.12. 2020

Nr. 1550 Prot., datë 10.12. 2020

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 464 datë 10.12. 2020

PËR TRANSMETIMIN E TË DHËNAVE TË PASAGJERIT TE NJËSIA E INFORMACIONIT TË PASAGJERIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 19/2 të ligjit nr.71/2016 “Për kontrollin kufitar” i ndryshuar, Ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZOJNË:

I. QËLLIMI

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i mënyrës së transmetimit të të dhënave dhe sigurimi i nivelit të përshtatshëm të mbrojtjes të të dhënave personale te Njësia e Informacionit të Pasagjerit (në vijim “NIP”), në rast shfaqjeje të një problemi teknik që pamundëson operimin e sistemit.

II. FUSHA E ZBATIMIT

Në rast shfaqjeje të një problemi apo mangësie teknike të sistemit, të tilla si probleme teknike të infrastrukturës përkatëse dhe linjës së transmetimit, transportuesit ajrorë, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore të tyre, do të dërgojnë të dhënat e pasagjerit, sipas formatit

të përcaktuar, në përputhje me nevojat e sistemit të ngritur, në një aplikacion alternativ për përpunimin e të dhënave të pasagjerit.

III. DETYRAT E NIP

1. Transportuesit ajror i transmetojnë NIP të dhënat PNR, sipas përcaktimeve të nenit 19/4 të Ligjit nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” i ndryshuar, 48 orë deri në 24 orë para kohës së planifikuar të nisjes së fluturimit dhe menjëherë pasi kanë përfunduar procedurat e imbarkimit dhe avioni është në përgatitje për nisje, duke përditësuar kështu të dhënat e transmetuara.
2. Transportuesit ajror i transmetojnë NIP të dhënat API deri në fund të *check-in*, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 19/2 të Ligjit nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” i ndryshuar.
3. NIP në kuadër të parandalimit të migracionit të paligjshëm, përmirësimit të kontrollit kufitar, të parandalimit, zbulimit, hetimit dhe ndjekjes penale të veprave penale të parashikuara në nenin 19/3 të Ligjit nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” i ndryshuar, konsulton të dhënat e aplikacionit alternativ me të dhënat e administruara në bazën e të dhënave të pasagjerit dhe rezultatet e përpunimit të tyre.
4. NIP, në përputhje me pikën 1 dhe 2 të këtij kreu, përpunon në bazën e të dhënave të pasagjerit, të dhënat e pasagjerit të parashikuara në nenin 19/2 të Ligjit nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” i ndryshuar, të cilat transmetohen nga transportuesit ajror, përfshirë të dhënat e pasagjerit me destinacion përfundimtar në Republikën e Shqipërisë, si dhe të atyre që udhëtojnë nga aeroporti i Republikës së Shqipërisë apo nëpërmjet tij.
5. NIP kryen administrimin elektronik të të dhënave të pasagjerit që transmetohen nga transportuesit ajror, si dhe të veprimeve që kryhen për përpunimin e tyre.
6. Regjistrimi dhe përpunimi i të dhënave të pasagjerit sipas qëllimit të parashikuar në kreun I të këtij udhëzimi, si dhe konsultimi apo përdorimi i të dhënave të pasagjerit, kryhet në mënyrë të tillë që punonjësi i NIP që përpunon të dhënat, si dhe punonjësi autorizuar i tij, të jetë i identifikueshëm.
7. Struktura përgjegjëse për Teknologjinë e Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit merr masat teknike dhe organizative, për zbatimin e afateve të ruajtjes, anonimizimin apo fshirjen automatike të të dhënave personale, që përpunohen në arkivat elektronike, për efekt të parandalimit të migracionit të paligjshëm, përmirësimit të kontrollit kufitar, të parandalimit, zbulimit, hetimit dhe ndjekjes penale të veprave penale të parashikuara në nenin 19/3 të Ligjit nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” i ndryshuar, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale që rregullojnë sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

IV. REGJISTRIMI DHE MBIKËQYRJA

1. Aplikacioni alternativ i të dhënave të pasagjerit funksionon në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, standardet teknike në fuqi në lidhje me sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit, duke analizuar nivelin e rreziqeve dhe dobësive të sistemit të përpunimit të të dhënave të pasagjerit.
2. Mbrojtja e të dhënave personale gjatë krijimit dhe mirëmbajtjes së aplikacionit alternativ të regjistrimit dhe përpunimit të të dhënave të pasagjerit është e detyrueshme për NIP.
3. Aplikacioni alternativ i të dhënave të pasagjerit do të ndërtohet dhe përdoret duke marrë parasysh standardet e sigurisë së informacionit, si më poshtë:
 - a) *“konfidencialitetin”*, duke siguruar që të dhënat të jenë të aksesueshme vetëm për personat e autorizuar;
 - b) *“integritetin”*, duke siguruar që të dhënat të jenë të sakta, të plota dhe duke ruajtur metodat e përpunimit të tyre;
 - c) *“disponueshmërinë”*, duke siguruar aksesin e përdoruesit të autorizuar në të dhënat dhe në sistemet e përpunimit;
 - d) *“besueshmërinë”* e sistemeve që janë përdorur për përpunimin e të dhënave dhe të personelit që i ka përdorur ato, duke garantuar që çdo aktivitet/veprim i tyre mbi të dhënat është i gjurmueshëm dhe i kontrollueshëm.
4. Analiza e riskut është pjesë përbërëse e standardeve të sigurisë së sistemit të përpunimit të të dhënave të pasagjerit. Rezultati i analizës së riskut do të jetë një listë e rasteve që mund të rrezikojnë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave personale të përpunuara, ndërkohë që ajo do të deklarojë edhe shkallën e riskut të mundshëm, propozimet e masave për eliminimin apo minimizimin e ndikimit të riskut.
5. Menjëherë pas vënies në punë të sistemit kryesor, të dhënat e përcjella nga transportuesit ajror të cilat ruhen në aplikacionin alternativ, do të regjistrohen nga punonjësi i NIP në sistemin kryesor. Njëkohësisht me transferimin e të dhënave në sistemin kryesor, do të bëhet edhe fshirja e tyre nga punonjësi i NIP në aplikacionin alternativ."
6. Kontrolli i rregullave për mbrojtjen e të dhënave të pasagjerit për respektimin e normave të sigurisë, për mbrojtjen e të dhënave kundër shkatërrimit/humbjes së tyre aksidentale, si dhe kundër aksesit (hyrjes), ndryshimit dhe përhapjes së paautorizuar të tyre realizohet nga personi i ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave (DPO), punonjësi i sigurisë së rrjetit, dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
7. Bazuar me germën ç) të nenit 19/7 të Ligjit nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbikëqyr

dhe monitoron, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, veprimtarinë e grumbullimit, të përpunimit, të shpërndarjes dhe të shkëmbimit të të dhënave të pasagjerit nga NIP dhe çdo dy vjet, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, vlerëson prodhimin dhe përdorimin e profileve të riskut dhe të modeleve të kontrollit, të krijuara nga NIP-i.

V. KONFIDENCIALITETI

1. Të gjithë punonjësit që kanë akses në bazën e të dhënave të pasagjerit sipas këtij udhëzimi detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë e të dhënave të përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, edhe pas përfundimit të funksionit.
2. Çdo punonjës që përpunon të dhënat e pasagjerit apo vihet në dijeni të tyre nuk mund t'i bëjë të njohur përmbajtjen e këtyre të dhënave, personave të tjerë të paautorizuar.

VI. SANKSIONET

Çdo person që përdor të dhënat dhe informacionet e bazës së të dhënave të pasagjerit të aplikacionit alternativ dhe nuk i fshin të dhënat sapo të jetë përmbushur qëllimi i mbledhjes së tyre, ndëshkohet me masa administrative dhe disiplinore sipas akteve normative në fuqi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM

SANDËR LLESHAJ



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE**

BESNIK DERVISHI

